



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-16-0190

S.V., Graqanicë

Ankues

Kundër:

E Paditur

SOE "Y", Përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** Rr. Agim Ramadani 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankueses, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjyqtarit me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-14-0532 të datës 20/06/2016 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2019 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditëses, refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vertetohet, Aktgjykimi i Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-se, C-IV-14-0532, i datës 20/06/2016.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat Procedurale

Me 30 janar 2014, ankuesi ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH Y nr.1/2014 të datës 8 janar 2014 me të cilin kërkesa për paga të papaguara për periudhën nga nëntori i vitit 2002 deri në mars të vitit 2004 në vlerë prej 1,210.01 euro ishte refuzuar për shkak të parashkrimit. Ankuesja theksoi se autoriteti i likuidimit nuk e ka marrë parasysh statusin e të punësuarës, kur emri i saj ishte përfshirë në listën e punëtorëve të kualifikuar, përfitues e 20% të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Ankuesja kuptoi se marrëdhënia e saj e punës ishte ndërprerë vetëm në qershor të vitit 2013 ku kishte pranuar vendimin në fjalë. Për këto arsye, ankuesja kërkon shpalljen e vendimit, nr.1/2014 të datës 8 janar 2014 të pavlefshëm dhe aprovimin e kërkesës së saj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëposhtëm: AKP) në mbrojtjen e saj ka kërkuar vërtetimin e vendimit të Komisionit për likuidim, në përputhje me nenin 70.4 të shtojcës së ligjit për Dhomën e Posaçme. Ajo theksoi se NSH e paditur kishte hyrë në likuidim, me 16 shtator 2013. Ankuesja që nga viti 2002, nuk ka kryer ndonjë punë që ndërlidhet me detyrat e saj ndaj punëdhënësit, kështu që ajo nuk mund të kërkojë pagat e papaguara për këtë periudhë kohore të kaluar. Për më tepër, padia është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar cili parasheh periudhën 3 vjeçare të parashkrimit për kthimin e pagave të papaguara. Mbi këtë bazë, në nëntor të vitit 2005 kërkesa për paga ishte parashkruar meqë nuk ishin marrë veprime për të ndërprerë rrjedhjen e kufizimit kohor në mes të 2002 dhe 2005.

Më 20/06/2016 Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-se nxori Aktgjykimin C-IV-14-0532, me të cilin ankesa ishte refuzuar si e pabazuar dhe vërtetoi vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-se, nr.1/2014 të datës 8 janar 2014 si të saktë dhe të bazuar në ligj. Kolegji i Specializuar arsyetoi se vendimi i AKP-se sqaron se në baze të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (G. Zyrtare nr. 53/76 i aplikueshëm) përcaktohet se 'Pagesat e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë

tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jete e parashkuar ne afatin prej 3 viteve.

Ankuesi nuk i kishte bashkangjitur asnjë provë të besueshme me të cilën do të dëshmonte se ai me kohë, për realizimin e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës i është drejtuar ndonjë organi pranë NSH-se. Ai nuk ka dorëzuar prova të tilla, ai vetëm pretendon se një e drejte e tillë i takon. Ankuesi nuk ka vërtetuar se ka qenë punëtor gjegjësisht se ka punuar ne NSH, deri ne privatizimin e saj me 16 shtator 2013.

Më 19/08/2016, ankuesi ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar C-IV-14-0532, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes së të drejtës materiale. Sipas ankueses ajo nuk ka pasur mundësi të përgjigjej ndaj mbrojtjes së paditurës për arsye se Gjykata nuk i ka servuar atë. Aktgjykimi është nxjerr në kundërshtim me nenin 182.2 të LPK-së, pa seancë dëgjimore. Më tutje ajo pohoi se Gjykata është dashur të marrë parasysh situatën në të cilën janë gjetur nacionaliteti serb, mungesës së lirisë së lëvizjes, nuk ka arritur të kërkoj mbrojtje gjyqësore të konsideroj se parashkrimi është ndërprerë që në vitin 2004 duke u bazuar në nenin 383 të LMD-së. Për më tepër për shkak se në këtë vit NSH është vendos edhe nën administrimin e AKP-së asaj i ka munguar edhe legjitimiteti pasiv. Më tutje ajo pohoi se parashkrimi ka filluar të rrjedh nga shtatori i 2013, koha kur ajo ka pranuar Njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës bazuar edhe në praktiken e DHPGJS-së, SCEL-09-0007. Sipas ankueses është bërë shkelja e të drejtës materiale sepse i është refuzuar e drejta e cila garantohet me ligje vendore dhe Konventa Ndërkombëtare andaj kërkon nga Kolegji i Apelit që Atë anulojë Aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën të kthejë në shkallë të parë për rigjykim.

Më 23/09/2016, AKP-ja parashtroi përgjigje ne ankesë. AKP-ja pohon se argumentet e ankuesit janë të pabazuara dhe aktgjykimi ankimor i Kolegjit të Specializuar dhe vendimi i autoritetit të Likuidimit duhen të vërtetohen me arsyetim se tre vite pas ndërprerjes së punës çdo e drejte parashkruhet në të kundërtën cenohet siguria juridike. Për arsyet e cekura me larte AKP-ja, kërkon

që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet, Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditëses është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet të vërtetohet.

Ankuesja në ankesë ka pohuar se nuk i është dorëzuar mbrojtja e AKP-së dhe nuk është mbajtur seanca dëgjimore lidhur me padinë e saj. Kolegji i Apelit vlerëson se nuk ishte gabim që nuk është dorëzuar mbrojtja për arsye se AKP-ja vetëm kishte kërkuar vërtetimin e Vendimit të Autoritetit të likuidimit i cili kërkesën e paditësit e kishte refuzuar mbi bazën e parashkrimit.

Sipas nenit 399.1 i LPK-së, "pasi të arrij përgjigja në padi, Gjykata konstaton se nga faktet e treguara nuk del themelësia e kërkesës ajo në themel do të refuzojë padinë si të pa bazuar". Paditësja nuk ka parashtruar asnjë provë me të cilat do të mbështet pohimet e veta. Prandaj Kolegji i Apelit vlerëson se nuk ishte gabim që nuk është mbajtur seanca dëgjimore pasi që paditësja nuk ka dorëzuar asnjë provë me të cilat do të vërtetohen pohimet e saja, ajo nuk ka treguar se çka do të mund të ndryshohet po të mbahej kjo seancë. Andaj për këtë arsye Kolegji i Apelit këtë pretendim ankimor e konsideron si të pabazuar.

Kolegji i Apelit ka gjetur se ankesa e paditëses është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet. Sipas provave në shkresat e lëndës, paditësja nuk ka parashtruar asnjë provë me të cilën vërtetonte, ndërmarrjen e ndonjë iniciative për kompensimin e pagave të pa paguara para një organi kompetent apo Gjykate.

Në një rast të tillë kolegji i Specializuar ka konstatuar ashtu si edhe Autoriteti i Likuidimit duk marrë për bazë kohën e privatizimit me kohën e parashtrimit të kërkesës, se kemi të bëjmë e kërkesën e parashkruar.

Prandaj ky Aktgjykim nuk mund të ketë ndikim për një rezultat tjetër të dhënë, nga ai që e ka dhënë Kolegji i Specializuar në Aktgjykimin e ankimuar.

Kërkesa siç ka konstatuar saktë, Kolegji i Specializuar në Aktgjykimin e ankimuar është parashkruar.

Në këtë lëndë kërkesa e paditësit është për paga të pa paguara, pra një kërkesë monetare ndaj NSH-së në likuidim, dhe afati tri vite i parashkrimit në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar rrjedhë te kërkesat monetare të kohëpaskohshme siç janë pagat, nga dita kur NSH-ja kishte ndërprerë pagesën e pagës. Është e qartë se nga dita e pagesës së pagës së fundit ,mars të vitit 2004 të pagës , koha e supozuar e marrjes së pagës deri në momentin e parashtrimit të kërkesës tek Autoriteti i likuidimit, më 21/11/2013 kanë kaluar më shumë se 3 vite, kërkesa tashmë ishte parashkruar.

Nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe duhet të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja nuk ngarkohet me taksë gjyqësore. Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e taksave gjyqësore ajo më 12/09/2018 ka paguar taksën gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 19 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtari Kryesues _____

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIT

Ju lutem të dorëzoni këtë Aktgjykim (përfshirë përkthimin në gjuhën Serbe) tek:

- Palët
- Kryesuesit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK-së në lëndën C-IV-14-0532.

Ilmi Bajrami, Gjyqtari Kryesues _____